



Abuzimi i fëmijëve në Evropë: Grupet e viktimave nga nisin iniciativën për përballje me rastet evropiane të abuzimit të fëmijëve

Në një takim ndërkombëtar në Zvicër, grupet e viktimave nga e gjithë Evropa filluan "Justice Initiative" ("Iniciativën për Drejtësi") në shkallë të gjerë. Me këtë nismë politike, abuzimi i fëmijëve, veçanërisht në institucionet shtetërore dhe kishtarë, për herë të parë do të trajtohet në mënyrë gjithëpërfshirëse në të gjitha vendet evropiane. Një mocion për të adresuar rastet e abuzimit në një nivel pan-Evropian do t'i prezantohet Këshillit të Evropës në Strasburg, në shtator.

Evropa ka shkelur mbrojtjen e fëmijëve për dekada të tëra: qindra mijëra fëmijë dhe të rinj u bënë viktima të shfrytëzimit, keqtrajtimit dhe abuzimit seksual. Në veçanti, abuzimet më të rënda ndodhën në institucionet shtetërore ose të drejtuara nga kisha. Në vende të ndryshme evropiane, deri para disa vitesh, kishte largim fëmijësh, birësime të detyruara, sterilizime dhe eksperimente të drogës/vaksinave tek fëmijët dhe të rinjtë. Në shumë raste në të gjithë Evropën, autoritetet shtetërore ishin pjesërisht përgjegjëse për vuajtjet, ose nuk arritën t'i mbrojnë fëmijët nga abuzimet dhe shkeljet e të drejtave të njeriut.

Deri më sot, këto raste abuzimi nuk janë trajtuar në shumicën e vendeve evropiane. Kjo tani duhet të ndryshojë. Grupet e viktimave nga e gjithë Evropa, si dhe akademikë dhe organizata jo-qeveritare (OJQ) kanë udhëtuar në Zvicër për të nisur "Justice Initiative". Kjo nismë politike tërheq vëmendjen kolektive në një pjesë të shtypur të historisë dhe tek viktimat që vuajnë ende sot për shkak të abuzimit dhe mungesës së njohjes publike.

Mbi një duzinë vende evropiane të përfshira në nisje - Kosova është gjithashtu në bord

"Shtetet duhet të adresojnë trashëgiminë e të kaluarës së vështirë dhe shkeljet e të drejtave të fëmijëve për të siguruar një shoqëri të drejtë dhe një të ardhme pa dhunë. Është e domosdoshme t'i bashkohemi kësaj nisme në ndjekjen e mënyrave të imagjinimit për të adresuar padrejtësitë e dhunshme të së shkuarës dhe të tashmes për viktimat dhe të mbijetuarit e formave të ndryshme të abuzimit. Shkeljet e të drejtave të njeriut nuk mund të kalojnë pa u vënë re, të mbuluara nga heshtja ndaj vuajtjeve dhe padrejtësive që kanë duruar viktimat dhe të mbijetuarit. Dhuna nuk mund të lihet pa u trajtuar. Është një detyrim moral dhe një përgjegjësi për shtetet dhe shoqëritë të kërkojnë në mënyrë aktive mjete ndëshkuese dhe restauruese për drejtësi për viktimat dhe të mbijetuarit si parakushte për shërim dhe pëmbyllje të së shkuarës," thekson Vjollca Krasniqi, profesoreshë e asocuar në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (Kosovë).

«Justice Initiative» mbështetet nga grupet e viktimave, akademikë dhe OJQ nga të gjitha pjesët e Evropës. Në një deklaratë të përbashkët të nënshkruar nga përfaqësuesit nga Evropa, njohja publike e padrejtësisë, dëmshpërblimi dhe analiza akademike e çështjes janë nxjerrë në pah www.justice-initiative.eu.

Mocioni për t'u paraqitur në Këshillin e Evropës brenda 2 javësh.

"Kjo nismë është qendrore për Evropën," thotë Presidenti i delegacionit zviceran në Këshillin e Evropës, Këshilltari Kombëtar Pierre-Alain Fridez. "Vetëm duke u pajtuar me të kaluarën, ne mund të ndërtojmë të ardhmen". Për këtë arsye, ai do të paraqesë një mocion në Strasburg në ditët në vijim që përmban kërkesat themelore të nismës dhe që duhet të çojë në një rivlerësim gjithëpërfshirës të këtij kapitulli të errët. Sipas politikanit evropian, ai është i bindur se mocioni do të gjejë një shumicë dërrmuese.



Zvicra si një model për rivlerësimin evropian

"Koha për dëshmperblimet po nxiton," shpjegon nismëtari Guido Fluri, i cili bashkë-sponsorizon nismën evropiane me fondacionin e tij me reputacion dhe ka marrë një doktoratë nderi nga Universiteti i Lucernit për angazhimin e tij në mbrojtjen e fëmijëve. "Shumica e viktimave tani janë të moshuar dhe të dobët. Ata duhet të përjetojnë gjatë jetës së tyre sesi padrejtësia njihet dhe trajtohet në të gjithë Evropën." Në Zvicër, Fondacioni Guido Fluri, së bashku me grupet e viktimave, e kanë bërë të suksesshëm "Iniciativën e Reparacioneve": më shumë se 10.000 viktima që kishin pësuar abuzimin më të rëndë kanë marrë dëshmperblim. Zvicra po punon në rastet e abuzimit shkencor dhe do të vazhdojë të mbështesë viktimat me projekte të ndryshme. Bazuar në përvojën zvicerane dhe zgjidhjet pozitive në vendet e tjera, grupet e viktimave nga e gjithë Evropa janë mbledhur për të ndjekur këtë rrugë politike edhe në nivel evropian. "Justice Initiative" është shprehje e kësaj përpjekjeje. Duke u pajtuar me të kaluarën, mbrojtja e fëmijëve në Evropë do të forcohet në plan afatgjatë.

Më shumë informacion në: www.justice-initiative.eu

Ju lutemi drejtoni pyetjet e mediave në: press@justice-initiative.eu